



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës*  
*Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force*  
**NJOFTIM PËR KONTRATË PUBLIKE KORNIZE**  
**SHERBIME**  
**Ri-tender**

*Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

**Data e përgatitjes së njoftimit: 23.05.2016**

<b>Nr i Prokurimit</b>	<b>21700</b>	<b>16</b>	<b>066</b>	<b>211</b>
------------------------	--------------	-----------	------------	------------

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



**NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES**

**I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

<b>Emri zyrtar:</b> Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës		
<b>Adresa Postare:</b> Kazerma “ Adem JASHARI”		
Qyteti: PRISHTINË	Qyteti: PRISHTINË	Qyteti: PRISHTINË
<b>Personi kontaktues:</b> Afrim Maxhuni		<b>Personi kontaktues:</b> Afrim Maxhuni
Email: <a href="mailto:afrim.maxhuni@rks-gov.net">afrim.maxhuni@rks-gov.net</a>		Email: <a href="mailto:afrim.maxhuni@rks-gov.net">afrim.maxhuni@rks-gov.net</a>
Adresa e Internetit ( <i>nëse aplikohet</i> ):		Adresa e Internetit ( <i>nëse aplikohet</i> ):

**Nëse po**, specifiko identitetin e të gjitha Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi.

**NENI II: LËNDA E KONTRATËS**

## II.1) PËRSHKRIMI

<b>II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:</b> <b>Ri-tender : “Shërbimet te projektimit dhe dizajni mit te projekteve te infrastrukturës për nevojat e FSK-se dhe MFSK-se”</b>		
<b>II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit</b> <i>(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)</i>		
<input type="checkbox"/> <b>Punë</b>	<input type="checkbox"/> <b>Furnizime</b>	<input checked="" type="checkbox"/> <b>Shërbime</b>
<input type="checkbox"/> Ekzekutim <input type="checkbox"/> Plani dhe ekzekutimi <input type="checkbox"/> Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	<input type="checkbox"/> Blerja <input type="checkbox"/> Qira financiare (lizing) <input type="checkbox"/> Qira <input type="checkbox"/> Blerje me këste <input type="checkbox"/> Një kombinim i këtyre	
Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve _____ _____	Vendi kryesor i dorëzimit .	Vendi kryesor i realizimit  Vendi kryesor i realizimit Hapësirat Afariste te Operatorit Ekonomik dhe hapësirat te Autoritetit Kontraktues neper te gjitha kazernat e FSK-se ne Kosove: Prishtine, Mitrovice, Ferizaj, Gjilan, Prizren, Istog , Pomozotin
<b>II.1.3) Njoftimi përfshinë</b>  Krijimin e kontratës publike kornizë <b>Po</b> <input checked="" type="checkbox"/>		
<b>II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):</b>  Kontrate publike kornizë me një operator <input checked="" type="checkbox"/>  <b>Ekzekutimi i kontratës:</b>  Thirrje/Porosi <input checked="" type="checkbox"/>  <b>Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj : 36</b>		
<b>II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës :</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• AK i MFSK-se dhe FSK-se ka për qëllim lidhjen një kontratë kornizë 36 muajsh ,për <b>“Shërbimet te projektimit dhe dizajnit te projekteve te infrastrukturës “</b>,me një OE qe do te ketë kapacitet te kryej shërbime te <b>Projektimit dhe dizajnit te projekteve te cilat duhet te behet ne nivele te larta profesionale dhe ne përputhshmëri te plote</b></li></ul>		

me ligjin e ndërtimit si dhe standardet evropiane për projektim dhe dizajnim të projekteve ndërtimore - si dhe standardet ISO 9001:2008 për ofrimin e shërbimeve të arkitekturës (projektim –dizajnim) për nevojat e FSK-se dhe MFSK-se .

**II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 93**



**II.1.7) Variantet pranohen** Jo

**II.1.8) Ndarja në Pjesë** Jo

**II.1.9) Ne rast të një apo me shumë pjesëve (nëse aplikohet):**N/A

**II.1.10) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)**

**II.1.11) Vlera e parashikuar e kontratës:** *Vlera e përafërt e kontratës për 36 muaj:*  
400,000.00€

## **II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS**

**Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)**  
**Sasia e përafërt e cila është planifikuar për kohëzgjatjen e kontratës prej 36 muaj:**

<b>Nr.1</b>	<b>Përshkrimi – Projekti ideor</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia (të përafërta) per tri vite</b>
<b>1</b>	<b>Punimi i projektit ideor - Arkitektura, organizimi, renditja dhe funksionaliteti i hapësirave brenda objektit, kostoja e perafert e ndertimit etj. Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>27,500.00</b>
<b>2</b>	<b>Punimi i projektit ideor - konstruksioni dhe stabiliteti i objektit - Statika.</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>27,500.00</b>
<b>3</b>	<b>Punimi i projektit ideor të instalimeve elektrike (Rryma e forte, Rryma e dobet etj).</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>27,500.00</b>
<b>4</b>	<b>Punimi i projektit ideor të instalimeve makinerike: Ngrohja qendrore, ventilimi, sistemi i ujit të ngroht sanitar, klimatizimi, panelet solare ,ashensori tej.</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>27,500.00</b>
<b>5</b>	<b>Punimi i projektit ideor të Hidroinstalimeve (Ujesjellesi, kanalizimi fekal, kanalizimi atmosferik).</b>	<b>m<sup>2</sup></b>	<b>27,500.00</b>

6	Punimi i projektit Ideor per rregullimin e partereve te objekteve, trotuaret, parqet, parkingjet etj - Arkitektura. Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m <sup>2</sup>	98,500.00
7	Punimi i projektit Ideor - Poligone te jashtme per trajnime fizike, terene sportive, poligone te gjuajtjes me armë etj - Arkitektura. Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m <sup>2</sup>	125,000.00
8	Punimi i projektit Ideor: Renovim te objektit - organizimi, renditja dhe funksionaliteti i hapësirave brenda objektit, kostoja e perafert e ndertimit etj.	m <sup>2</sup>	19,500.00
9	Punimi i projektit Ideor per pastrimin e germalmeve, demolim te objekteve si dhe formësim te siperfaqeve te kazermave dhe gjelbrim . Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m <sup>2</sup>	75,500.00

Nr.2	Përshkrimi – Projekti kryesor - Plair	Njësia	Sasia (të përafërta) per tri vite
1	Punimi i projektit Kryesor - Arkitektura, organizimi, renditja dhe funksionaliteti i hapësirave brenda objektit, paramas dhe parallogari . Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m <sup>2</sup>	27,500.00
2	Punimi i projektit Kryesor - konstruksioni dhe stabiliteti i objektit - Statika.Elaborati i gjeomekanikes (stabiliteti dhe aftesia mbajtes e tokes)	m <sup>2</sup>	27,500.00
3	Punimi i projektit Kryesor të instalimeve elektrike (Rryma e forte, Rryma e dobet ,IT-se etj.	m <sup>2</sup>	27,500.00
4	Punimi i projektit Kryesor të instalimeve makinerike: Ngrohja qendrore, sistemi i ngrohjes gjeotermale , klimatizimi, panelet solare ,ashensor etj.	m <sup>2</sup>	27,500.00
5	Punimi i projektit Kryesor të Hidroinstalimeve (Ujesjellesi, kanalizimi fekal, kanalizimi atmosferik).	m <sup>2</sup>	27,500.00

6	Punimi i projektit Kryesor per rregullimin e partereve te objekteve, trotualet, parqet, parkingjet etj - Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m <sup>2</sup>	98,500.00	
7	Punimi i projektit Kryesor - Poligone te jashtme per trajnime fizike, terene sportive, poligone te gjuajtjes me armë , poligone taktike -Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m <sup>2</sup>	125,000.00	
8	Punimi i projektit Kryesor: Inqizimi i gjendjes ekzistues dhe hartimi i projektit kryesor te Renovimit te objektit organizimi, renditja dhe funksionaliteti i hapësirave brenda objektit te ndertimit etj.	m <sup>2</sup>	19,500.00	
9	Punimi i projektit Kryesor per pastrimin e germalmeve, demolim te objekteve si dhe formësim te siperfaqeve te kazermave dhe gjelbrimin e siferfaqeve te kazermave . Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m <sup>2</sup>	75,500.00	
Nr.3	<b>Përshkrimi- Projektet urbane</b>	Njësia	Sasia (të përafërta) per tri vite	
1	Punimi i projektit Kryesor urban per nevojat e infrastruktures, inqizimi i objekteve ekzistuese , instalimeve nentoksore dhe mbitoksoredhe hartimi i planit urbanisti te kazermave te FSK-se .Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekt,	m <sup>2</sup>	186,500.00	
2	Punimi i projekteve kryesore të infrastrukturës – Rrugë, Parkingje dhe përmbajtjeve përcjellëse për nevojat e FSK-së. Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m2	65,000.00	
3	Punimi i projekteve kryesore të infrastrukturës – Hidroinstalime (Ujesjelles dhe përmbajtjeve përcjellëse për nevojat e FSK-së. Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m/L	8,500.00	

4	Punimi i projekteve kryesore të infrastrukturës – Kanalizim Fekal dhe Kanalizim Atmosferik) dhe përmbajtjeve përcjellëse për nevojat e FSK-së. Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m/L	8,500.00
5	Punimi i projekteve kryesore të infrastrukturës- Rrethojave te sigurisë se lokacioneve te FSK-se. Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m/L	34,500.00
6	Punimi i projekteve kryesore të infrastrukturës- Rrjeteve elektrike dhe ndriqimi jashtem te lokacioneve te FSK-se. Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m/L	18,500.00
7	Punimi i projekteve kryesore të infrastrukturës- Dixhitalizimi i lokacioneve te FSK-se (shtrirja e kablllove optike, kamerat e jashtme etj). Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m/L	8,500.00
8	Punimi i projekteve kryesore - Muret Mbrojtese nga betoni. Ne kete pozicion perfshihen edhe matjet gjeodezike te nevojshme per punimin e ketij projekti.	m/L	950.00

### II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj 36 (nga nënshkrimi i kontratës)

Apo:

Kontrata do te hy ne fuqi nga momenti i nënshkrimit te saje dhe do te zgjasë 36 muaj apo vite 3 kurse për fillimin e shërbimeve apo plani dinamik pas ç'do porosie:

- Afati kohor i kthim-dorëzimit te projekteve ideore –ditë kalendarike nga momenti i porosisë deri ne dorëzimin e tri projekte ideore te pranueshme dhe dorëzimit te projektit ideor te përzgjedhur sipas kërkesës (max. 30 dite kalendarike ) nga momenti i nxjerrjes se urdhër blerjes sipas kërkesës dhe nevojave te AK dhe ne përputhje me specifikacionin teknik te dhënë ne DT.
- Afati kohor i kthimit –dorëzimit te projektit zbatues – ditë kalendarike nga momenti i pranimit te projektit ideor te përzgjedhur dhe dorëzimi i projektit zbatues max. 30 dite kalendarike nga momenti i nxjerrjes se urdhër blerjes sipas kërkesës dhe nevojave te AK dhe ne përputhje me specifikacionin teknik te dhënë ne DT.

## NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

### III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit Po

*Nëse po*, vlera e sigurisë së ekzekutimit 10% e vlerës së kontratës me kohëzgjatje 37 muaj.

III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'u jepet kontrata (nëse aplikohet):

- Themelimi i entitetit ligjor në përputhje me dispozitat e parashikuara në dokumentet e tenderit.

III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës Po

*Nëse po*, përshkrimi i kushteve të veçanta

- Projektimet dhe dizajnimet duhet të bëhen në nivele të larta profesionale dhe në përputhshmëri të plote me ligjin e ndërtimit si dhe standardet evropiane për projektim dhe dizajnim të projekteve ndërtimore - si dhe standardet ISO 9001:2008 për ofrimin e shërbimeve të arkitekturës (projektim –dizajnim) .
- Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën e porosisë për kryerjen e shërbimeve projektuese-dizajnuese sipas pozicioneve të veçanta në para masë sipas nevojës dhe kërkesës së menaxherit të kontratës nga MFSK/FSK-ja ndërsa pagesa do të bëhet vetëm për porositë e kërkuara sipas çmimeve njësi në pozicione të veçanta në para masë.
- Porositë për kryerje të shërbimeve do të bëhen me shkrim nga menaxheri i kontratës duke precizuar emrin e projektit , llojin e shërbimit dhe porositë sipas pozicioneve të veçantë në para masë .
- Projekti ideor punohet në tri variante të pranueshme të projekteve ideore të cilat duhet të prezantohen dhe pranohen nga investitori dhe deri në pranim dhe përzgjedhje të projektit ideor të përshtatshëm . Në rast se këto tri ide nuk i plotësojnë kriteret dhe nuk i përmbushin objektivat e projektit atëherë bëhet përsëritja e procesit të projektit ideor dhe kryesor deri sa të arrihet zgjidhje e duhur ndërsa OE kontraktues barte pasojat eventuale të vonësave në planin dinamik të dorëzimit të projekteve ideore dhe kryesore sipas kontratës .
- Operatori ekonomik dizajnues është i obliguar të prezantoi projektet dhe arsyetoi ato para dhe arsyetoi ato para menaxherit të projektit dhe palëve të involvuara në projekt .
- Operatori ekonomik dizajnues obligohet që kurdo here që paraqiten probleme në realizim të projektit ,si pasoje e gabimeve në projekt ,të marrë masat e nevojshme për përmirësim të projektit dhe të barte pasojat e gabimeve projektuese.

#### ➤ Projekti Ideor :

Projekti ideor duhet të përmbaj:

- Situacionin e gjerë, (1:1000 ~ 1: 2500)

- Situacionin e ngushtë, (1: 500 ~ 1:1000)
- Bazat, (1:100 ~ 1:200)
- Prerjet karakteristike, (1:100 ~ 1:200)
- Fasadat, (1:100 ~ 1:200)
- Aksonometrinë, ( 1:100 ~ 1:200)
- Perspektiven,
- Projektet e te gjitha fazave te nevojshme sipas kërkesës.
- Përshkrimin teknik te punimeve, materializimin dhe arsyetimin funksional,
- Parallogarin e koston te objektit;

Projektet duhen të dorëzohen te lidhura ne format “A4”, në 2 kopje të forta dhe 2 kopje elektronike ne (PDF, archiCAD ose Auto CAD).

#### ➤ **Projekti Kryesor;**

Projekti kryesor - palir duhet të përmbaj:

- Situacionin e gjerë, (1:1000 ~ 1: 2500)
- Situacionin e ngushtë, (1: 500 ~ 1:1000)
- Te gjitha bazat, organizimi dhe funksioni, (1:50 ~ 1:100)
- Prerjet karakteristike (se paku katër prerje), (1:50 ~ 1:100)
- Projektet e te gjitha fazave te nevojshme ( statika , ujësjellësi dhe kanalizimi , instalimet elektrike ,instalimet e rrymave te dobëta , IT-se ,instalimet e makinerisë , elaborati i gjeomekanikes etj )
- Fasadat, (1:50 ~ 1:100)
- Aksonometrin, ( 1:50 ~ 1:100)
- Detalet, (1:10; 1:25)
- Perspektivat ,
- Përshkrimin teknik të punimeve, materializimin dhe arsyetimin funksional,llogarite termike ,akustike dhe llogarite tjera te nevojshme sipas specifikave te projektit
- Paramasen dhe parallogarinë,
- Projektin pas zbatimit – sipas nevojës dhe kërkesës .
- Dokumentacion tjetër te nevojshëm sipas ligjit dhe nevojave te institucionit

Këtu parashihet punimi i projektit-ve kryesore palir për objektet ndërtimore dhe përmbajtjeve përcjellëse të infrastrukturës .

- Projektet duhen të dorëzohen të lidhura ne format “A4”, në 4 kopje të forta dhe 4 kopje elektronike ne secilën nga programet ((PDF, archiCAD dhe Auto CAD) e cila eshte rregulluar dhe është e njëjte e renditur sikurse ne kopje fizike.

## **III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE**

### **III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:**

- a. **Deklaratë nën betim** - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.
- b. **Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore** e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.
- c. **Vërtetimin nga Gjykata Themelore** - Një formular ekstrakt nga “regjistri gjyqësor” apo,



në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit ku dëshmohet për **Seksioni II. FLETA E TË DHËNAVE të Tenderit (FTD)** të dosjes së tenderit të [Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik](#), (shiko dosjen e tenderit pjesën 6.4.

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- a. Deklaratë nën betim (Origjinali).
- b. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore - Origjinal
- c. Vërtetimin nga Gjykata Ekonomike - Origjinal .

Dokumentet (nën b dhe c) duhet të dorëzohen **vetëm nga tenderuesi fitues**, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështim në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me procedura të tjera konform LPP-se.

### **III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:**

1. Regjistrimi i OE në regjistrin profesional, komercial ose korporatës në vendin e themelimit , ofertuesi jo rezident sipas Ligjit aktual të Kosovës Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 është i detyruar të paraqesë certifikatën e regjistrimit të njësisë përhershme-para nënshkrimit të kontratës.
2. Regjistrimi i TVSH;
3. Regjistrimi i Numrit Fiskal
4. Certifikatën e Standardeve ISO 9001:2008 të vlefshme, për ofrimin e shërbimeve të arkitekturës (projektim -dizajn im) .

### **Dëshmia e kërkuar dokumentare:**

1. Certifikata e biznesit- Kopje
2. Certifikata e TVSH-se - Kopje
3. Certifikata e numrit fiskal- Kopje
4. Certifikata e Standardeve ISO 9001:2008- Kopje

### **III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar**

**Kërkesa 1.** Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se qarkullimet vjetore gjatë tri viteve të fundit ( 2013,2014 dhe 2015) ka qene ne vlere, se bashku për tre vitet , por jo me pak se. 600,000.00€

*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

**Evidenca 1.** Raportin ose raportet përkatëse nga një ose me shumë banka mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar nga ndonjë banke e licencuar – origjinal

### **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional**

**Kërkesa 1:** Operator Ekonomik duhet të dëshmoj se ka nënshkruar dhe realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit 2013, 2014 dhe 2015, min 3 (tri)kontrata të projektimit – dizajnit të projekteve, me min volum prej 400,000.00€,

**Vërejtje:**

**Ne rast të grupit të operatoreve ekonomik, lideri i grupit duhet të dëshmoj se ka nënshkruar dhe realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit 2013, 2014 dhe 2015, min 2 (dy)kontrata të projektimit – dizajnit me minimum volum prej 250,000.00€ , kurse anëtarët e tjerë të grupit duhet të ofrojnë dëshmi se kanë nënshkruar apo realizuar minimum një kontratë të projektimit – dizajnit në vlere prej min 150,000.00€**

**Kërkesa 2.** OE duhet të ofroj minimum të stafit Professional .

- inxh.Dipl. i Arkitekturës (apo master / jo bachelor) min. 2, me përvojë 5 vjeçare
- inxh.Dipl. i Ndërtimtarisë -konstruktiv (apo master / jo bachelor) min. 2, me përvojë 5 vjeçare
- inxh.Dipl. i Ndërtimtarisë -hidroteknik (apo master / jo bachelor) min. 1, me përvojë 5 vjeçare
- inxh.Dipl. i Makinerisë (apo master / jo bachelor) min. 1, me përvojë 5 vjeçare
- inxh.Dipl. i Elektroteknikës (apo master / jo bachelor) min. 1, me përvojë 5 vjeçare
- Gjeodet i licencuar (Inxhinier, master apo bachelor) min. 1, me përvojë 3 vjeçare

**Kërkesa 3.** Operatori Ekonomik duhet të caktoj një menaxherin të projektit nga stafi profesional , i cili duhet të një ( 1 ) Inxhinier i Diplomuar i Arkitekturës, me përvojë 5 vjeçare, mundet të jete njeri nga stafi profesional i prezantuar;( shembull: nga dy inxhinieret e kërkuar te arkitekturës njeri nga ta mund te caktohet)

### *Dëshmia e kërkuar dokumentare*

**Evidenca 1.** Listën e kontratave të natyrës se njëjtë te nënshkruar dhe realizuara në 3 vitet e fundit (2013,2014 dhe 2015) : Duhet të dorëzohet ne origjinal e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik.

Dëshmitë:

- Referencat sipas listës kontratave te prezantuara për shërbimet e ngjashme te cilat duhet të tregojnë vlerën, datën, natyrën e projekteve /apo aktiviteteve të shërbimeve dhe duhet të saktësojnë ne referencë nëse janë kryer shërbimet sipas kërkesës se AK, gjatë tre viteve te fundit ne vlerë prej min 400,000.00 Euro .
  - Nëse shërbimet projektimit dhe dizajni mit janë kryer për kompani private duhet te dëshmohet me pasqyra bankare – pasqyrat bankare (apo fletëpagese nga banka ) duhet te prezantohen ne origjinal nga ndonjë banke e licencuar
- Vërejtje:**
- Asnjë kontrate nuk do te llogaritet nëse nuk është e bashkangjitur referenca e sukseseshme ose pranimi teknik për kryerjen shërbimeve te natyrës se kërkuar pjese e këtij tenderi.

**Evidenca 2:** dëshmi për stafin profesional .

- 1.Diploma e noterizuar nga origjinali( diplomat duhet te dorëzohen të noterizuar në origjinal),
- 2.CV-it- duhet të dorëzohen në origjinal ose të noterizuar nga origjinali,
- 3.Deklarata e ekskluzivitetit dhe disponueshmërisë sipas aneksit 7 ne dosjen e tenderit - duhet të dorëzohet në origjinal,

**Evidenca 3 :** Vendim me shkrim mbi caktimin e një menaxheri te projektit **i vulosur dhe nënshkruar nga OE ne original.**

**Dëshmitë për menaxher te projektit :**

- 1.Diploma e noterizuar nga origjinali( diplomat duhet te dorëzohen të noterizuar në origjinal),
- 2.CV-it- duhet të dorëzohen në origjinal ose të noterizuar nga origjinali,
- 3.Deklarata e ekskluzivitetit dhe disponueshmërisë sipas aneksit 7 ne dosjen e tenderit - duhet të dorëzohet në origjinal.

**Vërejtje:**

**AK ka te drejt qe te verifikojë gjate fazës se vlerësimit te gjitha te dhënat- dëshmitë e**

paraqitura nga OE ne lidhje me aktivitetin e prokurimit ne fjale.

### III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
III.3.2) Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>

## NENI IV: PROCEDURA

### IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

[kliko njëzën dhe fshij te tjerat]

IV.1.1) Lloji i procedurës		
<input checked="" type="checkbox"/> E hapur		
IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata) Jo		
IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave (procedurë konkurruese me negociata)		
Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
Autoritetet kontraktuese do të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
IV.1.4) Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është : N/A		[shëno numrin]

### IV.2) KRITERET E DHËNIES

[Shëno në kutinë e duhur dhe fshije tjetrën]
<input checked="" type="checkbox"/> Tenderi i përgjegjshëm Çmimi më i ulët

### IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë	PO	<input checked="" type="checkbox"/>
Njoftimi për kontratë: 14.12.2015 Njoftimi për dhënie të kontratës: 01.03.2016 Njoftim mbi anulim të njoftimit të dhënies së kontratës: 25.04.2016 ( bazuar në vendimin e OSHP-se të datës 19.04.2016 ( PSH.Nr.64/16)		
IV.3.2) Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit		
Afati i fundit për pranimin e kërkesave për dosjen e tenderit: data 17/06/2016 në çdo ditë të punës në Kazerma “ Adem JASHAR” Prishtinë apo në email adresën <a href="mailto:afrim.maxhuni@rks-gov.net">afrim.maxhuni@rks-gov.net</a>		

Dokumentet me pages	Jo	<input checked="" type="checkbox"/>
<b>IV.3.3) Afati i fundit për pranim të tenderëve</b>		
20/06/2016 koha 13.00 vendi Objekti i MFSK-se ,Kazerma “ Adem JASHARI” Prishtine,		
<b>IV.3.4) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve është shkurtuar: <input checked="" type="checkbox"/> PO</b>		
<p>Arsyet e shkurtimit te afatit kohor për dorëzim te tenderëve është shkurtuar pasi qe i njëjti aktivitet i prokurimit është duke u ri-tenderuar.</p> <p>AK dëshiron qe ne afatin sa me te shkurtër te mundshëm ligjor te ketë kontratën për shërbimet e projektimit dhe dizajni mit , pasi qe shumë projekte kapitale te planifikuara për ketë vit fiskal kanë mbetur pa u zhvilluar si pasoj e mungesës se kontratës ne fjale. Ketë aktivitet te prokurimit e kemi filluar ne vitin fiskal 2015 mirëpo si pasoj e një ankese nga një OE dhe vendimit te vonuar nga OSHP-ja është shtyre edhe njoftimi për ta ri-tenderuar ketë aktivitet te prokurimit.</p>		
<b>IV.3.5) A është e nevojshme siguria e tenderit:</b>		
	Po	<input checked="" type="checkbox"/>
Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit: 10,000.00€		
Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 120 apo muaj 4		
<b>IV.3.6) Periudha e vlefshmërisë së tenderit: ditë 90 apo muaj 3</b>		
<b>IV.3.7) Takimi për hapjen e tenderëve:</b>		
20/06/2016 koha 13.30 vendi Objekti i MFSK-se ,Kazerma “ Adem JASHARI” Prishtine,		

## NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

### V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.

### V.2) INFORMACIONET SHITESË

**Shënim:** operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Shto informacione tjera:[si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj]

